



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2023-004

Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës -Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala A.L., avokat, për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares së Gjykatës Supreme M.D., me 09.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paraqitur nga pala A.L., ndaj gjyqtares së Gjykatës Supreme – M.D..

A r s y e t i m

Pala A.L., nga Mitrovica, më 10 shkurt 2023, ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtares së Gjykatës Supreme M.D., për kohën sa ishte gjyqtare në Gjykatën e Apelit, të cilën ankesë ia ka drejtuar autoritetit kompetentë - U.D. Kryetares së Gjykatës Supreme, nëpërmes postës.

Parashtruesi i ankesës avokat A.L., pretendon se gjyqtarja M.D., në kohën sa ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Apelit ka kryer shkelje disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.7 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtareve dhe prokurorëve. Sipas ankuesit me 31.10.2019, si përfaqësues i propozuesit në Gjykatën e Apelit kishte bërë kërkesë për delegim të kompetencës nga Gjykata e Apelit në Prishtinë tek dega e sajë në Mitrovicë, mirëpo, që nga ajo kohë gjyqtarja D., nuk kishte ndërmarr veprimet e nevojshme për të dërguar kërkesën tek kryetari i Gjykatës së Apelit, që të vendos lidhur me delegim, edhe përkundër që ishin parashtruar urgjenca nga ana e avokatit për përshpejtim të lëndës, dhe sa ka njohuri ai nuk është gjetur asnjë pengesë që ka mundur të ndikoj në mos trajtimin e lëndës në fjalë, fakt ky që vërtetohet nga urgjencat që ia ka bashkëngjitur kërkesës. Pastaj, me 8.02.2023 i është drejtuar me email kryetarit të Gjykatës së Apelit, e që administratori i gjykatës ia kishte kthyer këtë përgjigje “lidhur me shqetësimet e juaja për lëndët Ac.nr.5157/2019 ju njoftoj se kjo lëndë është pranuar

me 30.10.2019 dhe është caktuar tek gjyqtarja M.Gj., por pas avancimit të saj si gjyqtare në Gjykatën Supreme të Kosovës të gjitha lëndët e saj të pazgjidhura janë caktuar të gjyqarët tjerë. Kemi vendosur lidhur me delegimin me vendimin CN.nr.200/2022. Arsyeja e vonesave është se në vitin 2021 e 2022 kemi pranuar shumë lëndë të kontesteve të punës, paga jubilarë, shujta dhe kanë qenë të papërfunduara lëndët e vitit 2018, e këtë vit të gjitha lëndët e vitit 2019 do të përfundojnë në mesin e tyre edhe lënda juaj”. Mirëpo, ky arsyetim sipas ankuesit është jo logjik, konfuz ngase këto lëndë nuk janë lëndë që duhet të trajtohen me procedurë të shpejtë ngase këtë bazë ligjore e ka shpronësimi, prandaj konsideron se veprimet e gjyqtares janë në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e saj. Me tej, ankuesi citon dispozitat e ligjit mbi shpronësimin, dhe pretendon se gjyqtarja D., edhe përkundër që ka pasur obligim ligjor trajtimin e lëndës së lartcekur, e njëjta ka kryer lëndë të tjera që nuk kanë qenë me prioritet sipas ligjit dhe nuk ka marrë asnjë vendim meritator, përveç disa lëndëve me natyrë si pagat jubilarë, shujtat dhe dhunë në familje. Kërkesës ia ka bashkangjitur urgjencat e bëra, vendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë CN.nr.12/2018 datë 21.08.2019, ankesën e ushtruar ndaj këtij vendimi, kërkesën për delegim të kompetencës dhe emailin dërguar kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe vendimin e kësaj të fundit me cilin është vendosur lidhur kërkesën e ankuesit për delegim të kompetencës.

Me qëllim të vërtetimit bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj të pretendimeve të lartcekura si autoritet kompetent kam kërkuar nga gjyqtarja të deklarohet lidhur me këtë rast dhe kam pranuar deklaratën e të njëjtës.

Në deklaratën e saj gjyqtarja thekson se ka filluar punën si gjyqtare në Gjykatën e Apelit në janar të vitit 2019, kurse me lëndë është ngarkuar me 14.01.2019, dhe prej kësaj date deri me 24.10.2019, ka pranuar në punë 600 lëndë. Në këtë vëllim të lëndëve ka pranuar 39 lëndë të vitit 2016, 83 lëndë të vitit 2017, 192 lëndë të vitit 2018 dhe 305 lëndë të vitit 2019. Lëndët e pranuar të viteve 2016, 2017 e 2018, kanë qenë lëndë me urgjencë si konteste të punës, shpronësime, pengim posedim, masa të sigurisë, dhunë në familje dhe kanë pas prioritet sipas ligjit dhe kohës kur kanë arrite në gjykatë. Lënda konkrete nuk ka qenë e vetmja lëndë me objekt kontesti -caktimi i kompensimit të dëmit për paluajtshmerinë e shpronësuar që daton që nga viti 2019, sepse lëndë me natyrë të njëjtë ka pas edhe në lëndët e vitit 2016, 2017, 2018. Pastaj, kërkesat për urgjencë janë pranuar në shkrimore dhe i janë drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Apelit. Sipas rregullores në fuqi për organizimin e brendshëm të gjykatave, të gjitha kërkesat me shkrim që i dorëzojnë palët në gjykatë i pranon zyrtari administrativ ose referenti i shkrimores së gjykatës, i cili është i obliguar që ta vërtetojë përmbajtjen e kërkesës dhe t’ia dorëzojë atë gjyqtarit përkatës ose kryetarit. Në rastin konkret kërkesa në fjalë i është drejtuar kryetarit të gjykatës dhe jo edhe asaj si gjyqtare e çështjes. Pastaj, lënda konkrete se bashku me të gjitha shkresat është në gjuhen shqipe dhe e njëjta nuk ka qenë e përkthyer në mënyrë që ajo të kuptonte kërkesat lidhur me këtë rast, dhe kjo lëndë është pranuar në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme për shkak të virusit “Covid 19” kur gjykatat kanë punuar me kapacitet të kufizuar respektivisht të reduktuar. Ka propozuar që ankesa të refuzohet.

Pas analizimit të pretendimeve nga parashtruesi i ankesës, dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitur ankesës, deklaratës së gjyqtares, vlerësojë se në rastin konkret nuk ka vend për të hapur rast disiplinore për këto arsye:

Lënda civile me bazë juridike -kompensimi i paluajtshmerisë se eksproprijuar ku ankuesi është përfaqësues i palës propozuese sipas ankesës së përfaqësuesit është pranuar dhe regjistruar në Gjykatën e Apelit, Ac.nr.5157/2019 gjatë vitit 2019, dhe në këtë çështje ankuesi kishte bërë edhe kërkesë për delegimin e kompetencës nga Gjykata e Apelit në Prishtinë në Gjykatën e Apelit – Dega në Mitrovicë.

Është evidente se kjo lëndë sipas shkresave të kësaj çështje del të jetë caktuar tek gjyqtarja M., sa ishte gjyqtare në Gjykatën e Apelit dhe kjo lëndë nuk është kryer nga gjyqtarja madje edhe përkundër urgjencave të ankuesit, mirëpo, nga ky fakt vlerësoj se nuk mund të konkludohet se ajo në vazhdimësi nuk i ka kryer detyrat me kohë respektivisht se me veprimet e saj ka konsumuar shkelje disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.7 të Ligjit për përgjegjësi disiplinore ashtu siç pretendohet në ankesë.

Ngase, nga provat të cilat i janë bashkangjitur ankesës respektivisht urgjencat e bëra lidhur me këtë çështje (urgjencat e datave 2.10.2020, 2.06.2021 dhe 27.12.2022) del se ankuesi ju kishte drejtuar Gjykatës së Apelit për ta përsheptuar lëndën e lartcekur, por jo edhe kryetarit të Gjykatës së Apelit.

Ndërsa, është evidente se që nga viti 2013 kur edhe është bërë ristrukturimi i gjykatave departamentin civil i Gjykatës së Apelit përballet me lënda të vjetra, numri i të cilave është rritur nder vite fillimisht për shkak të numrit të madh të lëndëve të pranuar, por edhe numrit të vogël të gjyqtarëve dhe lëvizjeve të tyre nëpër instanca tjera gjyqësore.

Gjyqtarja M.G., e ka filluar punën në Gjykatën e Apelit në janar të vitit 2019 dhe është ngarkuar me 600 lëndë, madje edhe të viteve paraprake (2016, 2017 e 2018), të cilat kanë qenë me prioritet në raport me lëndët e vitit 2019, pra, nuk ka qenë vetëm lënda e parashtruesit të ankesës e natyrës urgjente, kurse është fakt notor situata e krijuar gjatë viteve 2020 dhe 2021 për shkak të pandemisë gjatë se cilës periudhë puna e gjykatave ka qenë e reduktuar.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes, si autoritet kompetent vlerësoj se pretendimi i ankuesit se gjyqtarja në vazhdimësi nuk i ka kryer detyrat me kohë dhe me këtë ka konsumuar shkeljen disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.7 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore është i pabazuar.

Nga arsyet e cekura me lartë, e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 nënpar. 3.2 të Rregullores së KGJK-së, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Gjyqtares M.D.,
3. Palës ankuese,

4. Arkivit të Gjykatës Supreme.